

Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Perëndimor të Timisoara, në Rumani

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete për degën e Gazetarisë në Universitetin Perëndimor të Timisoara, në Rumani, në kuadër të programit Erasmus + të Komisionit Europian.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime (*në degën e Gazetarisë*)
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie (*në degën e Gazetarisë*)
- Shkëmbimin e stafit administrativ për trajnim

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (studentët duhet të jenë të regjistruar në degën e Gazetarisë në programin Bachelor në Universitetin e Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e parë por ata duhet të jenë të paktën të regjistruar në vitin e dytë të studimeve të tyre.)
- **Master** (studentët duhet të jenë të regjistruar në degën e Gazetarisë në programin master në Universitetin e Tiranës.)
- **Doktoraturë** (studentët duhet të jenë të regjistruar në degën e Gazetarisë në programin e doktoraturës në Universitetin e Tiranës.)

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor 10 muaj
- Master 4 muaj
- Doktoraturë 4 muaj
- Staf Akademik për Mësimdhënie 5 ditë
- Staf Administrativ për Trajnim 5 ditë

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor/ditor (750 EUR në muaj për studentët/ 140 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe / ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Rumanisht B1, në varësi të programit të studimit);
- Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Perëndimor të Timisoara lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillojnë në fakultetin

tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Për më shumë informacion mbi lëndët e ofruara në degën e gazetarisë ju lutemi vizitoni http://ri.uvt.ro/?page_id=8868&lang=en

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti (dekan, zv.dekan, ose shef departamenti) dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Rumanisht B1, në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

* Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Perëndimor të Timisoara lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Për më shumë informacion mbi lëndët e ofruara në degën e gazetarisë ju lutemi vizitoni http://ri.uvt.ro/?page_id=8868&lang=en

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti (dekan, zv.dekan, ose shef departamenti) dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim studentët e **Doktoraturës**:

- CV+Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, i përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Diplomë e niveli bachelor;
- Listë notash e nivelit bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Diplomë e nivelit Master;
- Listë notash e nivelit master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht ose Rumanisht B1, në varësi të programit të studimit);
- Learning Agreement*;

* *Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët apo programin që do të zhvillojë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Perëndimor të Timisoara lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillojë në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillojë lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të frekuentoni lëndë dhe nuk do të merrni kredite në universitetin pritës por do të shkoni vetëm për hulumtim atëherë duhet ta përcaktoni këtë gjë në dokumentin e Learning Agreement. Për më shumë informacion mbi lëndët e ofruara në degën e gazetarisë ju lutemi vizitoni http://ri.uvt.ro/?page_id=8868&lang=en

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti (dekan, zv.dekan, ose shef departamenti) dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze)
- Kopje e mjetit të identifikimit (ID/pasaport)
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze)
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe)
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B2 për gjuhën angleze)
- Vërtetim nga fakulteti që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie

**Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyri gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

KUJDES! Kur të sillni në rektorat planin e mobilitetit për t’u firmosur nga Z. Skendaj, duhet të bashkëngjisni edhe dokumentin e vërtetimit nga fakulteti juaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së mësimdhënies për të kryer mobilitetin.

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
<http://bit.ly/1iNwOVk>

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin administrativ për trajnim:

- CV (në gjuhën angleze)
- Kopje e mjetit të identifikimit (ID/pasaport)
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze)
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe)
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B2 për gjuhën angleze)
- Vërtetim nga fakulteti që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.
- Plani i mobilitetit për trajnim

Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyri gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

KUJDES! Kur të sillni në rektorat planin e mobilitetit për t'u firmosur nga Z. Skendaj, duhet të bashkëngjisni edhe dokumentin e vërtetimit nga fakulteti juaj që ju lejon të shkëputeni gjatë kohës së mobilitetit.

*Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
<http://bit.ly/1MGGUDS>*

Afati i fundit për aplikime: 18 Nëntor 2016

Dokumentat duhen dorzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!